



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
NJESIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. _____ Prot.

Kuçovë, më 04 / 04 / 2025

**RAPORTI VJETOR I NDJEKJES SË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TE
AUDITIMIT TE BRENDSHEM TE LENA NE VITIN 2025**

Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, të Planit Vjetor 2026 nr. 3637 prot. date 15.10.2025, mbështetur në Kapitullin X të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm , *Parimi 15 “ Komunikimi i rezultateve të angazhimit dhe monitorimi i planeve të veprimit”* , si dhe ne zbatim te kreut IV te Udhezimit nr.42 date 27.10.2020 “*Mbi ndjekjen e zbatimit te rekomandimeve te dhena nga auditimi I brendshem ne sektorin public*”, Sektori I Auditimit te Brendshem Bashkia Kuçove, ka pergatitur Raportin Vjetor te ndjekjes se zbatimit te rekomandimeve te dhena per vitin 2025, te cilin e percjell te formatuar si me poshte:

Nr.	PERMBAJTJA	faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	
I.1	Hyrje	
I.2	Objektivat	
I.3	Qellimi	
I.3	Metodologjia	
I.4	Konkluzione	
II.	REZULTATET E VLERËSIMIT T ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIMIT	
III.	KONKLUZIONE	
IV	ANEKSE: (Pasqyrat 1 dhe 2)	

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të nenit 14, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, të Planit Vjetor 2026 nr. 3637., datë 17.12.2025, mbështetur në Kapitullin X të Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Standardeve Globale të Auditimit të Brendshëm, Parimi 15 “ Komunikimi i rezultateve të angazhimit dhe monitorimi i planeve të veprimit”, me qellim që të sigurohet mbikëqyrja sistematike mbi impaktin e punës të funksionit të auditimit të brendshëm, Njësia e Auditimit të Brendshëm bashkia Kucove, gjatë periudhës Janar – Mars 2026 ka realizuar angazhimet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e përfunduara gjatë vitit 2025.

Objektivi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është vlerësimi i progresit të bërë për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme, si dhe verifikimi i masave të ndërmarra për adresimin e gjetjeve të identifikuara.

Qëllimi i këtij auditimi është të sigurojë se rekomandimet e dhëna nga auditimit të brendshëm janë trajtuar në mënyrë të duhur, brenda afateve të përcaktuara, **dhe se** veprimet korrigjuese kanë kontribuar në përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, të qeverisjes dhe të menaxhimit të riskut

Objektivat e auditimit synojnë të:

1. **Verifikojë statusin aktual të zbatimit të rekomandimeve të mëparshme**, duke identifikuar ato që janë:
 - Zbatuar plotësisht
 - Zbatuar pjesërisht
 - Jo të zbatuara
2. **Vlerësojë cilësinë dhe efektivitetin e veprimeve të ndërmarra**, në raport me qëllimin e rekomandimeve.
3. **Identifikojë arsyet e mungesës së zbatimit ose të zbatimit të pamjaftueshëm të rekomandimeve**, duke adresuar faktorët pengues.
4. **Sigurojë informacion të besueshëm për titullarin e njësisë publike**, për gjendjen e progresit dhe masat e mëtejshme për përmirësimin e rekomandimeve.
5. **Mbështesë procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të kontrollit të brendshëm**, duke ofruar sugjerime të mëtejshme në rastet kur zbatimi është i pamjaftueshëm.

II. REZULTATET E VLERËSIMIT T ZBATIMIT TË REKMANDIMEVE TË AUDITIMIT

Rekomandimet e propozuara për 2025

Njësia e Auditimit të Brendshëm bashkia Kucove i ka kushtuar një vëmendje të veçantë procesit të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve. Ky proces është i rëndësishëm pasi mund të

kontribuojë në mënyrë thelbësore në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në të gjithë komponentët e tij dhe duke patur si qëllim përmirësimin e proceseve të punës.

Gjatë vitit 2025, nga NjAB Kucove janë kryer 6(gjashte) auditime ne fushat dhe sistemet e njesive perberese te bashkise dhe me konkretisht ne keto subjekte:

- 1- Qendra e Kultures.....Auditim i Kombinuar(Financiar dhe i Perputhshmerise);
 - 2- Inspektorati Vendor i Mbrojtjes se Territorit....Auditim i Perputhshmerise;
 - 3- Ndjekja e Zbatimit te Rekomandimeve te lena ne vitin 2024;
 - 4- Sektori i Prokurimeve PublikeAuditim i Perputhshmerise;
 - 5- Qendra Ekonomike e Arsimit.....Auditim I Kombinuar(Financ&Perputhshmer);
 - 6- Drejtoria e te Ardhurave vendore..Auditim i Perputhshmerise.
 - 7-
- Përmbledhje e rekomandimeve kryesore sipas fushave/proceseve të audituara :

Në sistemin qeverisjes dhe administrimi :

- Hartimin dhe miratimin e ndryshimeve ne Rregulloren e Brendshme të administrates se bashkise pas riorganizimeve të tyre ne vite, dhe dinamikës se legjislacionit ne ndryshim;
- Përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në subjektet e audituara, krijimin e “gjurmës së auditit” me proceset e detyrat e cdo punonjësi/ specialisti ne seicilen drejtori, për kordinimin e punës në kryerjen dhe monitorimin e shërbimeve.

Ne Sistemin e Prokurimeve për :

- Zhvillimin e procedurave për tenderat apo dhe procedurat e prokurimit me vlere te vogel, me pergjegjesi dhe conform kriterëve ligjore e normative;
- .Miratimi dhe përditësimi i Rregjistrit të Riskut per veprimtarite kryesore te Sektorit te Prokurimeve si dhe hartimi I strategjise se menaxhimit te tij
- Hartimin e miratimin e gjurmes specifike të auditimit për veprimtarite kryesore te Sektorit te Prokurimeve;

-Sistemi I Menxhimit te Ardhurave vendore per:

- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet tatim-paguese qe administrohen nga Drejtoria e te Ardhurave Vendore, specifikisht per bizneset, kategoria familjare si dhe fermeret sa I takon mardhenieve me pronesine apo dhe qeradheniet e tokes bujqesore
- planifikimi dhe realizimi I buxhetimit te te ardhurave, jo vetem ne total por dhe sipas kategorive e nenkategorive te taksapaguesve;
- Evidentimi dhe ndjekja e dinamikës se debitorëve dhe zbatimi I masave te plota ligjore shtrenguese

- Sistemi i zbatimit te politikave vendore ne fushen e arsimit parashkollor :

- Vendosijen e aktivitetëve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarine e ofrimit te sherbimit te menaxhimit te frekuentimit te kopshte-cerdheve, si dhe mirembajtjes se infrastructures se arsimit parauniversitar;

- Perditesimin, permiresimin dhe miratimin e rregullave specifike për menaxhimin sherbimeve ne fushen e arsimit dhe ne vecanti mardheniet kontraktuale me sipermarrjet private:
- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet sa I takon mardhenieve per faturat e furnizuesve si dhe detyrimet e familjeve per frekuentimin ne kopshte-cerdhe

-Sistemi i zbatimit te politikave vendore ne fushen e mbrojtjes te territorit :

- Vendosijen e aktiviteteve të kontrollit për vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e mangësive në veprimtarine e planifikimit dhe zhvillimit te territorit te bashkise Kucove;
- Ndjekja permanente e detyrimeve ligjore e fiskale per subjektet qe pajisen me leje ndertimi si dhe ato per legalizimin e ndertimeve informale ne bashkepunim te ngushte me Drejtorine e Urbanistikes se bashkise Kucove;
- Korelatimi I dokumentacionit me IKMT dhe drejtorine rajonale perkatese dhe bashkepunimi me keta te fundit per mbrojtjen e administrimin e territorit te bashkise Kucove

Pas auditimeve dhe ne funksion te Raportve Perfundimtare, te derguar subjekteve te audituara, janë dhënë 51 rekomandime¹ për përmirësimin e proceseve të punës më konkretisht:

- 7 rekomandime me nivel të lartë.
- 36 rekomandime me nivel të mesëm.
- 9 rekomandime me nivel të ulët.

Për vitin 2025, gjate veprimtarise audituese nga NJAB Kucove janë dhene gjithësej 51 rekomandime, nga të cilat :

Rekomandime të përmirësimit e sistemeve është propozuar 19 rekomandime, te cilat jane pranuar plotësisht nga menaxhimi. Rekomandimet jane kryesisht të njohjes dhe zbatimit nga strukturat e audituara te kritereve ligjore ne fushen e MFK.Me konkretisht per evidentimin e riskut/qeve me te cilat perballen subjektet, menaxhimin e ndikimit te tyre dhe formesimin e strategjise ndaj riskut nepermjet hartimit dhe funksionimit te aktiviteteve te kontrollit, dhe permiresimin e informimit dhe monitorimit.

-Rekomandime me karakter organizativ janë propozuar 18 rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi. Keto rekomandime janë në process zbatimi për arsye te nevojës se zoterimit nga strukturat e audituara te bazës ligjore e akteve normative e rregullatore, si dhe specifikes qe implementimi I tyre, duhet bere ne bashkërendim midis strukturave dhe nen drejtimin e Menxhimit te Larte te Bashkise Kucove..

- Rekomandime per arketime jane propozuar 0 rekomandime me nje vlere 0 leke, te cilat jane pranuar nga menaxhimi I subjektit te adresuar.

¹Nr. i rekomandimeve të dhëna dhe të pranuar do të jetë i njëjtë me numrin e deklaruar në Raportin Vjetor, seksioni 6 ie Anksit 5

-Rekomandime të tjera janë propozuar 14_ rekomandime, të cilat janë pranuar plotësisht nga menaxhimi.dhe mbeten në proces për shkak të procedurave qe duhen realizuar.

- Drejtimi I Nj.A.B kishte planifikuar per vitin 2025 dhe realizoi **me 1 angazhim auditimi specific**, “Auditimin për ndjekjen e rekomandimeve të auditimeve te meparshme”. Ne perfundim te ketij misioni rezultoi :

“Nga auditimi i ndjekjes se zbatimit te rekomandimeve në 5 subjektet e audituara ne vitin paraardhes 2024 janë rekomanduar gjithsej 72 masa, nga të cilat janë pranuar gjithsej po 72 masa ose në masën 100% . Verifikuam se, nga 72 masat e pranuar,- janë zbatuar plotësisht 18 masa ose në masën 25%,- janë zbatuar pjesërisht 14 masa ose 22_% e totalit të masave të pranuar, -janë në proces zbatimi 37 masa ose në masën 51_% dhe - pa zbatuar rezultuan 3 masa ose 2_%.”.

Treguesit e performancës lidhur me zbatimin e rekomandimeve të auditimit paraqiten si vijon :

Gjetjet e Auditimit dhe Efektiviteti²

- **% e rekomandimeve të pranuar nga menaxhimi.**

Formula:

$(\text{Numri i rekomandimeve të pranuar}) 51 * 100$

$(\text{Numri total i rekomandimeve}) \dots\dots\dots 51$

Përqindja e rekomandimeve të auditimit që janë pranuar nga drejtuesit është 100 %

- **% e rekomandimeve të zbatuara nga menaxhimi.**

Formula:

$(\text{Numri i rekomandimeve të zbatuara}) 16 * 100$

$\text{Numri i rekomandimeve të pranuar}) 51$

Përqindja e rekomandimeve të pranuar që janë zbatuar është ne masen 31.4 %

Nga sa më sipër janë zbatuar **31.4 %** e rekomandimeve të lëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm më konkretisht shikoni tabelën në vijim:

²Ky tregues është pjesë e Formatit Standard nr. 1, Aneksi 4 “ Treguesit kryesorë të performancës”

Emërtimi	Vlera në numër	Vlera në %
Zbatuar plotësisht	16	31.4 %
Në proces zbatimi	35	68.6 %
Pa zbatuar	0	0
Totali	51	100 %

Si konkluzion lidhur me zbatimin e rekomandimeve të dhëna gjatë vitit 2025, nga 51 rekomandimet të dhëna janë zbatuar 16 prej tyre; per 35 rekomandimet e dhëna evidentohen qe jane ne proces zbatimi, si dhe cilesojme se kemi 0 rekomandim qe nuk është zbatuar. Nga sa më sipër rezulton se niveli i zbatueshmërisë së rekomandimeve të dhëna për vitin 2025 është në **masen 31.4 %**. Kjo shkallë e nivelit të zbatimit të rekomandimeve ka ardhur si rezultat i disa faktorëve, më konkretisht:

- 1- Në zbatim të Programit të Auditimit nr.1111 Prot., datë 10.03.2026, “Programi i Angazhimit të Auditimit për Zbatimin e Rekomandimeve të dhëna në vitin 2025”, ka krijuar një impakt pozitiv për rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhereve në zbatimin e rekomandimeve nga strukturat e audituara.
- 2- Kryetari i Bashkisë Kucovë i ka kushtuar vëmendje procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe është angazhuar që ato rekomandime të cilat ishin në proces zbatimi të mund të implementohen sipas dhe në respektim të afatëve të caktuara dhe të dakordesuara mes paleve.
- 3- Mbetet i një rëndësie të veçantë, monitorimi i tyre i vazhdueshëm pasi vetë natyra e rekomandimeve të dhëna nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, përgjatë vitit 2025, janë dinamike, përfshijnë pjesëmarrjen e shumë faktoreve dhe aktoreve në zbatim, dhe pasi afati kohor luan një rol thelbësor në këtë proces.

Bashkëlidhur këtij raportimi, po ju dërgojmë si pjesë e këtij Raporti:

Pasqyrën nr.1 "Rekomandime sipas kategorive";

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Adriatik Carka

IV							
<i>Rekomandime të tjera</i>							
1	Rekomandime fushes kulturore	4	1	3	-	4	0
2	Rek. Menaxhimi i Territorit	3	1	2	-	3	0
3	Rekomand sektorit Prokurimeve	2	1	1	-	2	0
4	Rekokmand arkiv dosje ne QEA	3	2	1	-	3	0
5	Rekomandi permires per Dr.Ardhurave	2	0	2	-	2	0
	Shuma 4	14	5	9	0	14	0
	Shuma 5	0	0	0	0	0	0
	TOTALI (SHUMA 1 + SHUMA 2 + SHUMA 3 + SHUMA 4 + SHUMA 5)	51	16	35	0	51	0

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm

Adriatik Carka

ANEKSI 6: FORMATET STANDARD PËR RAPORTIN VJETOR TË NDJEKJES SË ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Formatet Standard Nr.3: Regjistri i Rekomandimeve të Auditimit

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË _____

Regjistri i rekomandimeve të auditimit për vitin 20 _____

Nr	Rekomandimi	Renditja sipas nivelit	Afati i përcaktuar			Struktura për realizimin e rekomandimeve	Statusi i rekomandimeve	Data e realizimit të rekomandimit	Komente nga audituesi / subjekti
			Data	Muaji	Viti				
1									
2									
3									
4									
5									
6									

Emërtimi	Vlera në numër	Vlera në %
Zbatuar plotësisht		

Drejtuesi i Auditimit të Brendshëm

emer mbiemër firmë _____

Në proces zbatimi		
Pa zbatuar		
Totali		